



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 nëntor 2015
Nr. ref.: RK854/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI44/15

Parashtrues

Hava Bajgora, Alban Bajgora dhe Sylejman Bajgora

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Drejtorisë së
Inspektionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës,
nr. 356-65493, të 20 marsit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: znj. Hava Bajgora, z. Alban Bajgora dhe z. Sylejman Bajgora nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), të cilët përfaqësohen nga z. Fatbardh Makolli, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktvendimin (nr. 356-65493, të 20 marsit 2015) e Drejtorisë së Inspektionit, Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Drejtoria e Inspektionit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesve të garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 prill 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI44/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI44/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 5 qershor 2015, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të specifikojnë vendimin e fundit të kontestuar, si dhe të dorëzojnë dokumente të tjera relevante lidhur me rastin.
8. Më 17 qershor 2015, parashtruesit iu përgjigjën kërkesës së Gjykatës.
9. Më 24 qershor 2015, kopja e kërkesës iu dërgua Drejtorisë së Inspektionit.
10. Më 10 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vitin 2001, z. Shefqet Bajgora, bashkëshorti tashmë i ndjerë i parashtrueses znj. Hava Bajgora dhe baba i parashtruesve z. Alban dhe z. Sylejman Bajgora, kishte lidhur një kontratë të shitblerjes për një objekt në Prishtinë.

12. Më 20 mars 2015, Drejtoria e Inspektionit (Aktvendimi nr. 356-65493) urdhëroi rrënimin e objektit të z. Shefqet Bajgora, bashkëshortit, përkatësisht babait të ndjerë të parashtruesve, të cilët në bazë të certifikatës të bashkësisë familjare që i është bashkëngjitur dokumentacionit të rastit, supozohen të jenë trashëgimtarët e tij. Në arsyetim të këtij aktvendimi u theksua:

“[...] Inspektori i ndërtimit i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës, pas kontrollit të bërë me procesverbal të dt. 20.03.2015, konstatoi se: objekti [...] ka pësuar dëmtime serioze dhe është i pambrojtur prandaj si i tillë përbën rrezik për shëndetin publik, ambientin dhe banorët e zonës.

Në bazë të nenit 34 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 17 pika 1 dhe 2, neni 39 pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit nenin 4 dhe neni 19 paragrafi 6 pika 6.1, 6.2 të udhëzimit administrativ MMPH Nr. 18/2013 për standardet minimale dhe procedurat për mbikëqyrje inspektive dhe lëshim të certifikatës së përdorimit, Inspektori i ndërtimit konstaton se objekti në fjalë paraqet rrezik për ambientin, rrezikon pronën e tjetrit dhe jetën e personave [...]”.

13. Në fund të aktvendimit të lartpërmendur theksohet me sa vijon:

“[...] UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi. Ankesa i ushtrohet Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Prishtinës”.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesit pohojnë se Drejtoria e Inspektionit ka rrënuar objektin e tyre pa dijen dhe njoftimin e tyre paraprak, vetëm një ditë pas nxjerrjes së aktvendimit të kontestuar, dhe në këtë mënyrë u ka shkelur atyre të drejtën për barazi para ligjit, të drejtën për mjete juridike, të drejtën për mbrojtjen e pronës si dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç garantohen me Kushtetutë.
15. Më tutje, parashtruesit pretendojnë se mosdorëzimi i njoftimit për rrënim të objektit të tyre “ju ka pamundësuar të drejtën në parashtrimin e provave dhe fakteve apo të drejtën e ankesës dhe të pjesëmarrjes në procedurat administrative në Komunë”.
16. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të anulohet vendimin e kontestuar si “kundërkushtetues” si dhe të “sanojë gjendjen e shkaktuar nga organet e komunale”, pa specifikuar se çfarë nënkuptojnë me sanim të gjendjes së shkaktuar.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës i cili parasheh:
- “[...] 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
19. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:
- “[...] Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
20. Më tutje, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë vetëm nëse:
[...]
(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.*
21. Siç u tha më lart, parashtruesit kontestojnë Aktvendimin (nr. 356-65493, të 20 marsit 2015) e Drejtorisë së Inspektionit, nëpërmjet të cilit ishte urdhëruar rrënimi i objektit të tyre. Parashtruesit pretendojnë se Drejtoria e Inspektionit, me këtë rast, u ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është vendim i shkallës së parë në procedurë administrative pranë Komunës së Prishtinës, dhe se ndaj të njëjtit ishte e lejuar ankesa, e cila do të shqyrtohej nga Komisioni për shqyrtim të ankesave të Komunës së Prishtinës.
23. Parashtruesit nuk kanë dorëzuar në Gjykatë ndonjë provë që dëshmon se ata janë ankuar kundër vendimit të kontestuar. Përveç kësaj, parashtruesit nuk kanë treguar nëse ata kanë bërë ndonjë përpjekje tjetër nëpërmjet mjeteve të tjera juridike për t'i siguruar të drejtat ligjore dhe kushtetuese, të cilat pretendojnë se u janë shkelur.
24. Prandaj, Gjykata konsideron se në këtë rast, kërkesa e parashtruesve është e parakohshme, pasi që procedura për ankesë para organit të shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës është ende në pritje, apo nuk është iniciuar fare nga parashtruesit.
25. Përveç kësaj, Gjykata vëren se ekzistojnë mjete të tjera juridike të cilat parashtruesit mund t'i shterin lidhur me ankesat e tyre, dhe se është përgjegjësi e tyre, që të shfrytëzojnë të gjitha mjetet e efektshme juridike para se të parashtrojnë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ndonjë akti, të ndonjë autoriteti publik në Gjykatën Kushtetuese.
26. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit duhet t'i shterojnë të gjitha mundësitë

procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, apo të korrigjojnë shkeljet eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

27. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: *AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/ 09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendim i 29 korrikut 1999).
28. Në përfundim, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar nga organi kompetent, i cili në këtë fazë do të mund të ishte objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve është e parakohshme, për shkak të moshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi